



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 234 Prot.

Tiranë, më 6/2 /2017

VENDIM

Nr. 13, datë 6/2 /2017

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi/ Komiteti Shqiptar i Helsinkit, përfaqësuar nga Znj. \_\_\_\_\_, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr. 1446 Prot., datë 13.12.2016, ndaj Autoritetit Publik/ Ministrisë së Mbrojtjes me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumentave zyrtare".

Ankuesi në cilësinë e kërkuesit, me shkresën nr. 497-497/1, datë 27.10.2016 ka kërkuar nga Ministria e Mbrojtjes t'i vihet në dispozicion informacioni dhe dokumentacioni i disponueshëm si më poshtë vijon:

- a) Nëse institucioni juaj ka hartuar planin vjetor që lidhet me procesin e vendimmarrjes të vitit 2015 dhe 2016, bazuar në nenin 6, pika 1, gërma "b" e Ligjit Nr.146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik". Nëse po lutemi të na përcillni kopje të këtyre planeve.
- b) Cilat janë format dhe mënyrat me anë të të cilave janë bërë publike këto plane vjetore? Nëse publikimi është bërë gjithashtu me anë të internetit, lutemi të na përcillni adresën ndërlidhëse (linkun përkatës).
- c) Listën e projekt-akteve (projektligje, projekt strategji, politika me interes të lartë publik) që janë përfunduar së hartuari nga institucioni juaj brenda periudhës Janar – Tetor 2016. Cilat nga këto projekt-akte i janë nënshtruar procesit të njoftimit dhe konsultimit publik? Për ato projektakte që nuk i janë nënshtruar këtij procesi, lutemi të na informoni mbi arsyet përkatëse.
- d) Kopje të njoftimeve publike për procesin e konsultimit publik që janë bërë për secilin projekt – akt që i është nënshtruar këtij procesi sipas nenit 6/a dhe 11/1 të Ligjit Nr.146/2014, si dhe kopje të njoftimeve për konsultime të drejtpërdrejta dhe takime publike me palët e interesuara sipas nenit 6, pika 2 e këtij ligji, për periudhën Janar-Tetor 2016.
- e) Kopje të ftesave, axhendave, listë prezencave dhe procesverbaleve të mbajtura në takimet publike të organizuara për konsultimin publik për secilin



projektlig/projektstrategji/projektpolitike sipas nenit 18 të ligjit Nr.146/2014, për periudhën Janar-Tetor 2016.

- f) Kopje të përmbledhjeve të rekomandimeve të pranuar dhe arsyeve të mospranimit të rekomandimeve për çdo projekt akt që i është nënshtruar procesit të konsultimit gjatë periudhës Janar-Tetor 2016 sipas nenit 19, pika 3 të Ligjit Nr.146/2014.
- g) Kopje të raportit të transparencës për procesin vendimmarrës të institucionit tuaj për vitin 2015 dhe linkun ku këto raporte janë publikuar sipas nenit 20 të Ligjit Nr.146/2014.
- h) Informacion lidhur me ankesat e palëve të interesuara për cënim të së drejtës për njoftim dhe konsultim publik dhe ecurinë e shqyrtimit të tyre nga Institucioni Juaj, sipas nenit 21 të ligjit Nr.146/2014, për periudhën Janar-Tetor 2016.

Me shkresën nr.6643/3 Prot., datë 15.11.2016, Autoriteti Publik ka kthyer përgjigje duke sqaruar ndër të tjera se: "...Programi i përgjithshëm analitik i projektakteve që propozohen për miratim nga ministritë miratohet dhe publikohet çdo vit nga Këshilli i Ministrave. Ministria e Mbrojtjes gjatë vitit 2016 ka konsultuar 3 projekt-ligje, të cilat janë publikuar edhe në faqen zyrtare: 1.Projektligj "Për një ndryshim në ligjin 9179, datë 29.01.2004 "Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake" të ndryshuar, për të cilin janë zhvilluar disa takime dhe janë mbajtur proces-verbale. 2.Projektligj "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9363, datë 24.03.2005 "Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit", të ndryshuar, për të cilin nuk është shfaqur interes nga ndonjë grup interesi. 3.Projektligj Draft-Strategjia Kombëtare për mos Përhapjen e Armëve të Dëmtimit në Masë", i publikuar në faqen zyrtare. Gjatë vitit 2016 janë miratuar edhe dy projektligje, për të cilët nuk është bërë konsultim publik. Projektligj "Për disa shtesa në ligjin nr. 10142, datë 15.05.2009 "Për Sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. Për këtë projektligj nuk është bërë konsultim publik, pasi qëllimi ishte përfshirja e punonjësve civilë të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes në skemën e sigurimeve shoqërore suplementare dhe nuk ka grupe interesi pasi subjekte të këtij ligji janë punonjës civilë të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes. Për projektligjin "Për zhvillim dhe pjesëmarrjen e forcave ushtarake të Britanisë së Madhe në stërvitjen e përbashkët "Albanian Lion 2016", nuk është bërë konsultim, pasi qëllimi i tij është të lejojë zhvillimin dhe pjesëmarrjen e forcave ushtarake të Britanisë së Madhe në stërvitjen e përbashkët "Albanian Lion 2016", në kuadër të bashkëpunimit dypalësh me Britaninë e Madhe. Për aktet që i janë nënshtruar procesit të konsultimit publik, nuk ka patur ankesa nga palët e interesuara.

Pas përgjigjes së dhënë nga Autoriteti Publik/ Ministria e Mbrojtjes, ankuesi pretendon se është cënuar në të drejtën për informim, pasi nuk është informuar lidhur me sa ka kërkuar dhe për këtë arsye ka depozituar ankim pranë Zyrës së Komisionerit. Në këto kushte ankuesi kërkon nga KDIMDP, ushtrimin e kompetencave që ju njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e dhënies së informacionit/dokumentacionit nga autoriteti publik.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" në të cilin citohet se "Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ...kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë



*dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve*”, vlerësoi zhvillimin e një seance dëgjimore përpara marrjes së vendimit përfundimtar. Me shkresën nr. 20/19 Prot., datë 05.01.2017, Zyra e Komisionerit njoftoi palët në një seancë dëgjimore në datën 16.01.2017. Në seancë dëgjimore, pala ankuese dhe përfaqësuesit e Autoritetit Publik paraqitën qëndrimet e tyre lidhur me rastin, duke rikonfirmuar qëndrimet e tyre të reflektuara në aktet shkresore të trajtuara më sipër.

Pas shqyrtimit të ankesës, si dhe pas konsultimit të legjislacionit përkatës rezultoi se, dokumentacioni i kërkuar në pikat e kërkesës së Komitetit Shqiptar të Helsinkit është vendosur pjesërisht në dispozicion ankuesit, më konkretisht:

- *Informacion nëse Ministria e Mbrojtjes ka hartuar një plan vjetor që lidhet me procesin e vendimmarrjes për vitin 2015, 2016 si dhe një kopje të tyre, sipas nenit 6, pika 1/b, të ligjit nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.*
- *Për projektligjin e konsultuar gjatë vitit 2016, dokumentacioni që lidhet me kopje të njoftimeve publike për procesin e konsultimit, kopje të njoftimeve për konsultime të drjtëpërdrejta, ftesat, axhendat, listë-prezencat, procesverbalet e mbajtura në takimet publike, mendimet e dërguara nga palët e interesuara sipas nenit 6, pika 1/a, pika 2, nenit 11/1 dhe nenit 18 të ligjit Nr.146/2014.*
- *Kopje të përmbledhjeve me arsyet e mospranimi të rekomandimeve për projektligjin që i është nënshtruar procesit të konsultimit sipas nenit 19, pika 3, e Ligjit Nr.146/2014.*
- *Kopje e raportit të transparencës për procesin vendimmarrës për vitin 2015, siç kërkohet në nenin 20, të Ligjit Nr.146/2014.*

Nga administrimi i provave, rezultoi se dokumentacioni i kërkuar në pikën a), si dhe informacioni i kërkuar në pikat d), e), f) dhe g) për Projektligjin “Për një ndryshim në ligjin 9179, datë 29.01.2004 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërhyrje të industrisë ushtarake” të ndryshuar, nuk është vënë në dispozicion.

Për sa më lart, Zyra e Komisionerit vlerëson se, dokumentacioni i kërkuar përbën informacion publik në kuptim të pikës 2, të nenit 2, të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, “informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik” dhe si i tillë, duhet vendosur në dispozicion të kërkuarit Komiteti Shqiptar i Helsinkit, nëse ky informacion disponohet nga Autoriteti Publik,

Theksojmë, se e drejta për t’u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e Komitetit Shqiptar të Helsinkit, përfaqësuar nga Znj. \_\_\_\_\_, ndaj Autoritetit Publik/ Ministria e Mbrojtjes, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

## **PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëve shjeve administrative”,

## VENDOSA:

1. Pranimin e ankesës së Komitetit Shqiptar të Helsinkit, përfaqësuar nga Znj. nr. 1446 Prot., datë 13.12.2016, ndaj Autoritetit Publik/ Ministria e Mbrojtjes, me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik/ Ministria e Mbrojtjes, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar sipas objektivit të kërkesës (shkresa nr. 497-497/1, date 27.10.2016), brenda datës 13.2 .2017.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.
4. Ky vendim u dha sot në datë 6.2 .2017.

